

DEPARTAMENTI EKONOMIK

Nr. 8484 / 13 Prot.

Tiranë, më 08/03 2018

Lënda: Përgjigje shkresës suaj Nr.44/5 Prot. datë 23.02.2018 “Në lidhje me detyrat e lëna gjatë seancës dëgjimore në datën 16.02.2018”.

Drejtuar: Z. Petrit AHMETI
Kryetar i Bordit të Komisionerëve të ERE

TIRANË

I Nderuar z. Ahmeti,

Në përgjigje të shkresës suaj Nr.44/5 Prot. datë 23.02.2018 “Në lidhje me detyrat e lëna gjatë seancës dëgjimore në datën 16.02.2018” ju lutem gjeni përgjigjen tonë duke përdorur të njëjtën renditje si në shkresën tuaj:

1. Percaktimi i kostove te arsyeshme dhe rillogaritja e te ardhurave te kerkuara te ndare per aktivitetin e shperndarjes dhe per aktivitetin e furnizimit te energjise elektrike.

Në përputhje me sugjerimin tuaj u krye studimi për metodologjinë e ndarjes së shpenzimeve operacionale të Operatorit të Shërbimit të Shpërndarjes dhe Operatorit të Furnizimit Universal, i cili ndodhet bashkëngjitur këtij dokumenti.

2. Evidentimi i kostove sa me te drejta per llogaritjen e tarifave te shërbimit te shperndarjes te ndare sipas 3 grupeve te niveleve te tensionit 35 kV, 20-10-6 kV dhe 0,4 kV. Lidhur me evidentimin e ketyre kostove ju kujtojme se u angazhuat per kryerjen e simulimeve ne lidhje me percaktimin e humbjeve ne keto nivele tensioni.

Në përputhje me të dhënat e përfituara për ndarjen e shpenzimeve operacionale, sipas buxhetit të aprovuar 2018, bazuar në metodologjinë sa më sipër kryem rillogaritje të tarifave të shpërndarjes të ndara në nivel tensioni të cila rezultojnë si më poshtë:

DEPARTAMENTI EKONOMIK

Tarifat e Operatorit të Shpërndarjes për nivel tensioni

000/Lekë

Zëri	2018	Tension i Mesëm	Tension i Mesëm	Tension i Ulët
		35 kV	20-6 kV	0.4 kV
Shpenzime Operative	9,592,179	36,391	1,351,683	8,204,105
Kosto e transmetimit për humbjet	1,045,654	7,934	143,381	894,338
Kosto e humbjeve	8,905,662	33,786	1,254,943	7,616,934
Total OPEX	19,543,496	78,111	2,750,007	16,715,378
Vlera e investimeve në v. 2011	35,502,006			
Vlera e investimeve në v. 2012	765,883			
Vlera e investimeve në v. 2013	448,465			
Vlera e investimeve në v. 2014	1,208,133			
Vlera e investimeve në v. 2015	1,626,099			
Vlera e investimeve në v. 2016	7,130,056			
Vlera e investimeve në v. 2017	9,953,110			
Vlera e investimeve që priten në v. 2018	6,250,135			
Vlera e asetëve Gjithsej	62,883,887	753,210	11,864,422	50,266,255
minus: Amortizimi i akumuluar	(29,254,074)	(350,399)	(5,519,421)	(23,384,254)
vlera e RAB pa përfshirë kapitalin e punës	33,629,813	402,811	6,345,000	26,882,002
Kapitali i punës	4,885,874	6,509	229,167	4,650,197
RAB	38,515,687	409,320	6,574,167	31,532,199
Norma e interesit të borxhit të vjetër	1.19%	1.19%	1.19%	1.19%
Norma e interesit të borxhit të ri	2.01%	2.01%	2.01%	2.01%
Kthimi i lejuar mbi kapitalin e vet	16.44%	16.44%	16.44%	16.44%
Borxhi i vjetër %	29.73%	29.73%	29.73%	29.73%
Borxh i ri %	30.27%	30.27%	30.27%	30.27%
Raport i synuar i kapitalit të vet	40.00%	40.00%	40.00%	40.00%
Kthim për borxhin e vjetër	0.35%	0.35%	0.35%	0.35%
Kthim për borxhin e ri	0.61%	0.61%	0.61%	0.61%
Kthimi i lejuar mbi kapitalin e vet	6.58%	6.58%	6.58%	6.58%
WACC	7.54%	7.54%	7.54%	7.54%
Fitimi	2,903,900	30,861	495,661	2,377,378
Amortizimi i vitit	2,958,096	35,431	558,110	2,364,555
Të ardhura nga lidhjet e reja	(375,677)	-	(75,379)	(300,298)
Të ardhurat nga energjia reaktive	(355,938)	(10,676)	(295,360)	(49,902)
Totali i të Ardhurave të Kërkuara	24,673,877	133,727	3,433,038	21,107,111
Energji e lëvruar nërjetin e shpërndarjes MWH	4,803,209	57,532	906,231	3,839,447
Tarifa mesatare e Shpërndarjes Lekë/KWh	5.14	2.32	3.79	5.50

DEPARTAMENTI EKONOMIK

Tarifa e Shërbimit të Furnizimit Universal 000/Lekë

Zëri	2018
Shpenzime Operative	2,614,889
Kosto e Energjisë së shitur nga FPSH (+Marzh)	16,841,325
Kosto e transmetimit	3,311,237
Marzhi	505,240
Kompensimi i Borxhit të Keq	3,169,725
Kompensim për humbjet 2012 - 2014 (CEZ)	2,818,842
Totali i të Ardhurave të Kërkuara	29,261,257
Energji e shitur në rrjetin e shpërndarjes MWH	4,803,209
Tarifa mesatare e shitjes Lekë/KW	6.09

3. Në lidhje me planin e investimeve, vërejmë se OSHEE parashikon se të gjitha investimet dote kryhen me fondet e veta, duke mos qartësuar nëse fitimet e akumuluar gjatë periudhave të mëparshme ushtrimore do të perdoren totalisht për financimin e këtyre investimeve apo për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura.

OSHEE është një shoqëri me kapital tërësisht shtetëror në pronësi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë. Financimi i Investimeve është bërë gjithmonë në përputhje me vendimet e Këshillit Drejtues të Asamblesë së Përgjithshme të OSHEE që udhëhiqet nga kjo Ministri. Vendimet e këtyre organeve kanë detajuar financimin e masës së investimeve dhe burimet e tyre.

Shlyerja e detyrimeve të prapambetura sikundër kemi theksuar shpesh në përgjigje të ngulmimit tuaj të vazhdueshëm, së fundi edhe sipas shkresës Nr. 2494 Datë 14.02.2018 është kryer në përputhje të plotë me Planin e Rimëkëmbjes të miratuar me VKM Nr. 171 Datë 25.02.2015.

Ju rikujtojmë se pagesat ndaj KESH dhe OST kanë qenë gjithmonë më të mëdha se ato të parashikuara në Planin e Rimëkëmbjes.

4. Në vijim të komunikimit tuaj me shkresën nr. 2494/1, datë 14.02.2018 ju rikujtojmë dergimin e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur 2017 pas mbylljes së tyre, në mënyrë të vecantë pasqyrën Cash Flow, e cila duhet të shoqërohet me informacion të detajuar mbi zerat e arketimeve të shitjes së energjisë elektrike dhe pagesat e kryera për detyrimet e shoqërisë, vecanërisht ndaj operatoreve të sistemit dhe detyrimet ndaj tyre.

Bashkëngjitur Pasqyrat Financiare paraprake për vitin 2017 pjesë e së cilave është edhe paqyra e Cash Flow.

Me konsideratë,

Adrian ÇELA
Administrator

OPERATORI I SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE SH.A



**METODOLLOGJIA PËR NDARJEN E SHPENZIMEVE
OPERATIVE:**

**OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES /
FURNIZUESI I SHËRBIMIT UNIVERSAL**

OSHEE sh.a.

Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike

Adresa : Bulevardi "Gjergj Fishta", Ndërtesa Nr.88 H.1, Njësia Administrative Nr.7, 1023
Tiranë

Përmbajtja:

I. Domosdoshmëria e Ndarjes së Shpenzimeve Operative	3
II. Metodologjia e Përdorur.....	5
III. Përzgjedhja e Koefficienteve dhe Përlllogaritja e tyre.	5
a) <i>Koefficienti Shpërndarje</i>	6
b) <i>Koefficienti Shitje</i>	6
c) <i>Koefficienti 1</i>	7
d) <i>Koefficienti 2</i>	8
e) <i>Koefficienti 3</i>	8
IV. Ndarja e Shpenzimeve Operative të Buxhetuara për vitin 2018.	9

I. Domosdoshmëria e Ndarjes së Shpenzimeve Operative

Domosdoshmëria e Ndarjes së aktiviteteve të OSHEE është përcaktuar në kushtet e Ligjit 43/2015 dhe nga Vendimi i Këshillit të Ministrave për Modelin e Tregut si vijon:

a) Ligji Nr. 43/2015 “PËR SEKTORIN E ENERGJISË ELEKTRIKE”

Neni 1

Qëllimi i këtij ligji është garantimi i furnizimit të qëndrueshëm dhe të sigurt me energji elektrike të klientëve, nëpërmjet krijimit të një tregu funksional dhe konkurrues të energjisë elektrike, duke marrë në konsideratë interesat e klientëve, sigurinë e cilësinë e shërbimit të furnizimit me energji elektrike dhe kërkesat për mbrojtjen e mjedisit.

Neni 2

Objekti i ligjit

Ky ligj rregullon marrëdhëniet në veprimtaritë e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike, si dhe vendos rregullat lidhur me:

- a) hapjen, organizimin dhe funksionimin e një tregu konkurrues të energjisë elektrike;
- b) pjesëmarrjen në tregun e energjisë elektrike;
- c) dhënien e autorizimeve dhe licencave në sektorin e energjisë elektrike;
- ç) rregullimin e veprimtarive në sektorin e energjisë elektrike, mbrojtjen e klientëve, sigurinë e furnizimit dhe krijimin e strukturave konkurruese të tregut të energjisë elektrike;
- d) integrimin e tregut shqiptar në tregun rajonal dhe atë europian të energjisë elektrike.

Neni 72

Ndarja e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes

1. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes duhet të jetë i ndarë dhe i pavarur nga aktivitetet e tjera, të cilat nuk kanë të bëjnë me shpërndarjen e energjisë elektrike.

b) Modeli i Tregut

Në vendimin për Modelin e Tregut sipas VKM Nr.244, date 30.3.2016 është saktësuar nevoja për ndryshimin e Tregut të energjisë elektrike si kusht për krijimin e tregut rajonal të energjisë për të cilën Shteti Shqiptar është angazhuar, bazuar në:

DEPARTAMENTI EKONOMIK

- Kërkesat e Traktatit të Komunitetit të Energjisë ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë;
- angazhimeve të marra në Samitin e Vjenës 27.08.2015;
- angazhimin për krijimin e Bursës Shqiptare të Energjisë.

Domosdoshmëria e ndarjes së aktiviteteve të OSHEE buron edhe nga *Qëllimi i Modelit të Tregut* i cili është: Të krijojë kushtet për një treg konkurrues të energjisë elektrike.

Mosndarja e aktiviteteve të OSHEE do të bëhet pengesë për arritjen e *Objektivave të Modelit të Tregut* në Shqipëri të cilat përfshijnë:

- liberalizimin e plotë të tregut të energjisë elektrike dhe krijimit të një tregu/tregjeve të organizuara;
- sigurimin e përputhshmërisë së Modelit Shqiptar të Tregut me dispozitat e Traktatit të Komunitetit të Energjisë;
- funksionimin të tregut të energjisë si treg i energjisë balancuese;
- sigurimin e likuiditetit të nevojshëm;
- rritjen e efikasitetit dhe qëndrueshmërisë së sektorit.

Roli i Operatorit të Shpërndarjes në Modelin e Tregut përcaktohet në pikën 3.2 të këtij vendimi si vijon:

“ 3.2 Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH)

OSSH-ja do të zotërojë, mbajë, zgjerojë dhe operojë sistemin e shpërndarjes së energjisë elektrike dhe do të ndahet nga furnizimi, në përputhje me rregullat e Komunitetit të Energjisë.

OSSH-ja do të ofrojë shërbimin e lidhjes për të gjithë përdoruesit e sistemit të lidhur me rrjetin e shpërndarjes në kushte jodiskriminuese.

OSSH-ja do kryejë blerjen e humbjeve teknike dhe joteknike në tregun e organizuar të ditës në avancë (BSHE). Për një periudhë ndërmjetëse, ku produktet që tregtohen në një treg të organizuar nuk lejojnë blerjen me kosto optimale të humbjeve, procedurat e prokurimit janë të lejuara për OSSH-në, sipas rregullave të miratuara nga ERE.

Tarifat, afatet dhe kushtet e aksesit në sistemin e shpërndarjes do të rregullohen nga ERE.

OSSH-ja do të jetë përgjegjëse për reduktimin e humbjeve teknike dhe joteknike në sistemin e shpërndarjes, në bazë të një studimi të përgatitur nga konsulentë ndërkombëtarë, të kontraktuar nga OSSH-ja dhe të miratuar nga ERE. ERE do të vendosë një tarifë për OSSH-në, që siguron incentiva për reduktimin e këtyre humbjeve.

OSSH-ja do të jetë një PPB.”

DEPARTAMENTI EKONOMIK

II. Metodologjia e Përdorur

Riorganizimi dhe ndarja e aktiviteteve të OSHEE është akoma në proces dhe pritet të finalizohet në fund të vitit 2018. Kjo do të shoqërohet edhe me sistemin e ndarë dhe të detajuar të evidentimit të kostove të veçanta për shoqëritë që do të krijohen dhe që do të funksionojnë edhe si pjesë të një Shoqërie të integruar (holding) për të cilën do të evidentohen pasqyra financiare të konsoliduara.

Në plotësim të nevojës së menjëhershme që ka shoqëria për të evidentuar shpenzimet e ndara sipas aktiviteteve në kushtet e përcaktimit të tarifave të shpërndarjes së energjisë elektrike si dhe për të krijuar një bazë për saktësimin e mëtejshëm të këtyre shpenzimeve më poshtë është përdorur metoda e ndarjes me Koeficientë.

III. Përzgjedhja e Koeficienteve dhe Përlllogaritja e tyre.

Përzgjedhja e Koeficientëve është mbështetur në këto kritere kryesore:

- Evidentimi i llogarive të shpenzimeve që për nga natyra i përkasin tërësisht aktiviteteve të ndara.
- Gjetja e llojit të Koeficientëve sipas natyrës së shpenzimeve dhe raportit llogjik dhe më të përafëruar të tyre për evidentimin e shpenzimeve.
- Përcaktimi i numrit të punonjësve sipas aktiviteteve të ndara dhe përdorimi i raportit të numrit të punonjësve si një Koeficient bazë.

Bazuar këto kritere u përcaktuan koeficientët si vijon:

- a) **Koeficienti Shpërndarje** – për llogaritë e kostos 100% shpërndarje
- b) **Koeficienti Shitje** – për llogaritë e kostos 100% shitje
- c) **Koeficienti 1** – Koeficient bazuar ne numrin e punonjesve
- d) **Koeficienti 2** – Koeficient bazuar ne shpenzimet materiale
- e) **Koeficienti 3** – Koeficient bazuar ne shpenzimet per qera

Për 3 koeficientët e fundit u mundësua llogaritja e tyre mbi bazën e të dhënave të detajuara të departamenteve të OSHEE nga të cilat u vlerësua edhe pesha specifike sipas aktiviteteve të ndryshme në OSHEE në %.

Koeficientët shërbyen si bazë për ndarjen e shpenzimeve që janë evidentuar përbashkësisht në llogaritë e kostove të OSHEE dhe nuk mund të ndahen nëpërmjet metodave të drejtëpërdrejta si dhe për shpenzimet administrative që i përkasin të gjithë aktiviteteve.

DEPARTAMENTI EKONOMIK
Llogaritja e Koefficienteve të Përzgjedhur:

a) Koefficienti Shpërndarje

Emertimi i Koefficientit:	Pershkrimi	Raporti i Përzgjedhur	
Shpendarje	Koefficient per llogarite e shpenzimeve 100% Shpërndarje	Operatori i Sistemit te Shpërndarjes OSSH	Furnizuesi i Sherbimit Universal FSHU
		100.00%	0.00%

Llogaritë e drejtpërdrejta ku zbatohet ky Koefficient dhe grupimet paraqiten në tabelën si më poshtë:

Nr. Llog.	Pershkrimi	Grupi i shpenzimeve	Koefficienti
602100	Shpenzime operative (materiale)	Shpenzime Mirembjatje	Shpërndarje
615100	Riparime dhe mirëmbajtje e ndërtesave	Shpenzime Mirembjatje	Shpërndarje
615200	Riparime dhe mirëmbajtje e makinave	Shpenzime Mirembjatje	Shpërndarje
615300	Riparime dhe mirëmbajtje - te tjera	Shpenzime Mirembjatje	Shpërndarje
615350	Riparim transformatoresh	Shpenzime Mirembjatje	Shpërndarje
618400	Shpenzime Kolaudimi Matesash	Shpenzime Mirembjatje	Shpërndarje
618500	Shpenzime Transporti	Te Tjera	Shpërndarje

b) Koefficienti Shitje

Emertimi i Koefficientit:	Pershkrimi	Raporti i Perzgjedhur	
Shitje	Koefficient per llogarite e shpenzimeve 100% Shitje	OSSH	FSHU
		0.00%	100.00%

Llogaritë e drejtpërdrejta ku zbatohet ky Koefficient dhe grupimet paraqiten në tabelën si më poshtë:

Nr. Llog	Pershkrimi	Grupi	Koefficienti
626100	Sherbimi postar (shperndarja e fatures)	Sherbime per Arketime dhe Komunikimi	Shitje
626200	% nga posta per mbledhjen e arketimeve	Sherbime per Arketime dhe Komunikimi	Shitje
626210	% Arketim Fature Energj.nga Shoqeri Financiare	Sherbime per Arketime dhe Komunikimi	Shitje
618300	Shpenzime Printimi Faturash	Te Tjera	Shitje

DEPARTAMENTI EKONOMIK

c) Koeficienti 1

Emertimi i Koeficientit:	Pershkrimi	Raporti i Perzgjedhur	
Koeficient 1	Koeficient bazuar ne numrin e punonjesve	OSSH	FSHU
		82.01%	17.99%

Llogaritja e raportit të Koeficientit 1

Treguesi: Numri i Punonjësve

	Nr.	Punonj. Admin. per Njesi	Total	Koeficient 1
OSSH	4,612	464	5,076	82.01%
FSHU	1,012	102	1,114	17.99%
Admin.	566			
TOTAL	6,190	566	6,190	100.00%

Zërat e kostos ku zbatohet ky Koeficient dhe grupimet paraqiten në tabelën si më poshtë:

Nr. Llog	Pershkrimi	Grupi	Koeficienti
601100	Karburante dhe lende te tjera djegese	Shpenzime materiale dhe konsumi	Koeficient 1
602110	Shpenzime operative materiale kancelarie	Shpenzime materiale dhe konsumi	Koeficient 1
641100	Pagat e personelit	Shpenzime për personelin	Koeficient 1
644000	Kontributi I Sigurimeve Shoqerore	Shpenzime për personelin	Koeficient 1
648100	Shpenzime te tjera (antidoda dhe ushqimi)	Shpenzime për personelin	Koeficient 1
648200	Shpenzime per bonuse dhe shperblime	Shpenzime për personelin	Koeficient 1
657000	Penalitete,gjoha e demshperblime	Penalitete dhe gjoha	Koeficient 1
657100	Demshperblim-Çeshtje Gjyq. dhe Permbar.	Penalitete dhe gjoha	Koeficient 1
657110	Demshp.Tarif Permbar	Penalitete dhe gjoha	Koeficient 1
624000	Maredhenie me Publikun	Maredhenie me Publikun dhe Marketing	Koeficient 1
613100	Qera per Makina	Qera	Koeficient 1
626000	Shpenzime Telefoni, Interneti	Sherbime per Arketime dhe Komunikimi	Koeficient 1
626050	Shpenzime Postare	Sherbime per Arketime dhe Komunikimi	Koeficient 1
626400	Shpenzime postare dhe te telekom.(VDF)	Sherbime per Arketime dhe Komunikimi	Koeficient 1
726400	Vodafone konsum personeli	Sherbime per Arketime dhe Komunikimi	Koeficient 1
615400	Riparime dhe mirëmbajtje - IT	Shpenzime Teknologjia e informacionit	Koeficient 1
622000	Shpenzime ligjore	Shpenzime Ligjore	Koeficient 1
622200	Konsulence dhe auditim	Konsulence dhe auditim	Koeficient 1

DEPARTAMENTI EKONOMIK

604300	Uje	Te Tjera	Koeficient 1
604900	Shpenzime Uji per Fatura te Pamberritura	Te Tjera	Koeficient 1
608200	Diferenca nga kursi per inventarin	Te Tjera	Koeficient 1
616100	Primi I sigurimit	Te Tjera	Koeficient 1
618000	Te tjera	Te Tjera	Koeficient 1
618100	Trajnime, kurse, e takime te tjera	Te Tjera	Koeficient 1
625000	Transferta, udhetime dhe dieta	Te Tjera	Koeficient 1
626300	Sherbime te tjera	Te Tjera	Koeficient 1
628000	Komisione bankare dhe interesa	Te Tjera	Koeficient 1
638000	Taksa te tjera	Te Tjera	Koeficient 1
638100	Taksat per automjetet	Te Tjera	Koeficient 1
638300	Shpenzim per detyrime ndaj ERE	Te Tjera	Koeficient 1
645000	Tarifa ish te Perndjekurit Politike (1%)	Te Tjera	Koeficient 1
653000	Shpenzime Receptionsi dhe Sponsorizime	Te Tjera	Koeficient 1
658000	Shpenzime operative te tjera	Te Tjera	Koeficient 1

d) Koeficienti 2

Emertimi i Koeficientit:	Pershkrimi	Raporti i Perzgjedhur	
Koeficient 2	Koeficient bazuar ne shpenzimet materiale	OSSH	FSHU
		95%	5%

Bazuar në natyrën e materialeve (kryesisht rroba dhe vegla pune) sipas daljes nga magazina.

Nr. Llog	Pershkrimi	Grupi	Koeficienti
602120	Shpenzime operative materiale te tjera	Shpenzime materiale dhe konsumi	Koeficient 2
608100	Diferenca cmimi (kostoje)	Shpenzime materiale dhe konsumi	Koeficient 2

e) Koeficienti 3

Emertimi i Koeficientit:	Pershkrimi	Raporti i Perzgjedhur	
Koeficient 3	Koeficient bazuar ne shpenzimet per qera	OSSH	FSHU
		55.61%	45.39%

Llogaritja e raportit te **Koeficientit 3**

Treguesi: **Shpenzime për Qera Mujore**

DEPARTAMENTI EKONOMIK

	Lekë	Admin per Njesi (/Koef.1)	Total	Koeficient 3
OSSH	2,113,863	9,937,974	12,051,836	54.61%
FSHU	7,835,649	2,180,665	10,016,315	45.39%
Admin.	12,118,639			
TOTAL	22,068,151	12,118,639	22,068,151	100.00%

Zërat e kostos ku zbatohet ky Koeficient dhe grupimet paraqiten në tabelën si më poshtë:

Nr. Llog	Pershkrimi	Grupi	Koeficienti
613000	Qera	Qera	Koeficient 3
613200	Qera te tjera	Qera	Koeficient 3
618200	Sherbimi I sigurimit	Te Tjera	Koeficient 3

IV. Ndarja e Shpenzimeve Operative të Buxhetuara për vitin 2018.

Në tabelën më poshtë Ndarja e Shpenzimeve Operative të buxhetuara të vitit 2018 në OSSH dhe FSHU:

	OSHEE OPEX (000 / Lekë)	Buxhet 2018	Koef.	OSSH	FSHU	OSSH	FSHU
	<i>SHPENZIMET OPERATIVE</i>						
C01	Shpenzime materiale dhe konsumi	408,028				350,573	57,455
601100	Karburante dhe lende te tjera djegese	180,000	Koef 1	81%	19%	145,869	34,131
602110	Shpenzime materiale kancelarie	85,400	Koef 1	81%	19%	69,207	16,193
602120	Shpenzime operative materiale te tjera	140,000	Koef 2	95%	5%	133,000	7,000
608100	Diferenca cmimi (kostoje)	2,628	Koef 2	95%	5%	2,497	131
C20	Shpenzime për personelin	6,419,219				5,202,045	1,217,173
641100	Pagat e personelit	4,405,233	Koef 1	81%	19%	3,569,939	835,294
644000	Kontributi i Sigurimeve Shoqerore	817,959	Koef 1	81%	19%	662,862	155,096
648100	Shpenzime (antidoda dhe ushqimi)	804,006	Koef 1	81%	19%	651,555	152,451
648200	Shpenzime per bonuse dhe shperblime	392,021	Koef 1	81%	19%	317,688	74,333
C50	Mirembajtje	2,567,967				2,567,967	-
602100	Shpenzime operative (materiale)	1,500,000	Shpërndarje	100%	0%	1,500,000	-
615100	Mirëmbajtje e ndërtesave	10,000	Shpërndarje	100%	0%	10,000	-
615200	Riparime dhe mirëmbajtje e makinave	126,600	Shpërndarje	100%	0%	126,600	-
615300	Riparime dhe mirëmbajtje - te tjera	1,330	Shpërndarje	100%	0%	1,330	-
615350	Riparim transformatoresh	300,000	Shpërndarje	100%	0%	300,000	-
618400	Shpenzime Kolaudimi Matesash	630,038	Shpërndarje	100%	0%	630,038	-
C70	Penalitete dhe gjoba	1,000,000				810,386	189,614
657000	Penalitete,gjoba e demshperblime	161,596	Koef 1	81%	19%	130,955	30,641
657100	Çeshtje gjyqesore dhe Permbarim	824,506	Koef 1	81%	19%	668,168	156,338
657110	Demshp.Tarif Permbar	13,898	Koef 1	81%	19%	11,263	2,635
C92	Maredhenie me Publikun, Marketing	14,000				11,345	2,655

DEPARTAMENTI EKONOMIK

624000	Maredhenie me Publikun	14,000	Koef 1	81%	19%	11,345	2,655
C93	Qera	465,805				303,274	162,531
613000	Qera	280,000	Koef 3	55%	45%	152,913	127,087
613100	Qera per Makina	185,000	Koef 1	81%	19%	149,921	35,079
613200	Qera te tjera	805	Koef 3	55%	45%	440	365
C94	Sherbime per Arketime dhe Komunik.	725,870				25,022	700,848
626000	Shpenzime Telefoni, Interneti	30,000	Koef 1	81%	19%	24,312	5,688
626050	Shpenzime Postare	3,789	Koef 1	81%	19%	3,071	718
626100	Sherbimi (shperndarja e fatures)	351,427	Shitje	0%	100%	-	351,427
626200	% nga posta per arketimet	189,103	Shitje	0%	100%	-	189,103
626210	% Arketim Energj. Shoqeri Financiare	154,464	Shitje	0%	100%	-	154,464
626400	Postare dhe te telekomunikimit (VDF)	34,014	Koef 1	81%	19%	27,564	6,450
726400	Vodafone konsum personeli	(36,927)	Koef 1	81%	19%	(29,925)	(7,002)
C95	Shpenzime Teknologjia e Inform.	310,000				251,220	58,780
615400	Riparime dhe mirëmbajtje - IT	310,000	Koef 1	81%	19%	251,220	58,780
C96	Shpenzime Ligjore	7,788				6,312	1,477
622000	Shpenzime ligjore	7,788	Koef 1	81%	19%	6,312	1,477
C97	Konsulence dhe Auditim	119,000				96,436	22,564
622200	Konsulence dhe auditim	119,000	Koef 1	81%	19%	96,436	22,564
C90	Te tjera	1,169,391				753,388	416,003
604300	Uje	3,882	Koef 1	81%	19%	3,146	736
604900	Uji per Fatura te Pamberritura	1,336	Koef 1	81%	19%	1,083	253
608200	Diferenca nga kursi per inventarin	5,552	Koef 1	81%	19%	4,499	1,053
616100	Primi I sigurimit	157,598	Koef 1	81%	19%	127,716	29,883
618000	Te tjera	35,000	Koef 1	81%	19%	28,364	6,636
618100	Trajnime, kurse, e takime te tjera	2,739	Koef 1	81%	19%	2,219	519
618200	Sherbimi I sigurimit	450,000	Koef 3	55%	45%	245,754	204,246
618300	Shpenzime Printimi Faturash	100,000	Shitje	0%	100%	-	100,000
618500	Shpenzime Transporti	30,000	Shpërndarje	100%	0%	30,000	-
625000	Transferta, udhetime dhe dieta	110,744	Koef 1	81%	19%	89,746	20,999
626300	Sherbime te tjera	131,000	Koef 1	81%	19%	106,161	24,839
628000	Komisione bankare dhe interesa	6,103	Koef 1	81%	19%	4,946	1,157
638000	Taksa te tjera	21,438	Koef 1	81%	19%	17,373	4,065
638100	Taksat per automjetet	4,943	Koef 1	81%	19%	4,006	937
638300	Shpenzim per detyrime ndaj ERE	60,000	Koef 1	81%	19%	48,623	11,377
645000	Tarifa ish te Perndjekurit Politike (1%)	44,052	Koef 1	81%	19%	35,699	8,353
653000	Sponsorizime e Subvecone	5,000	Koef 1	81%	19%	4,052	948
658000	Shpenzime operative te tjera	3	Koef 1	81%	19%	2	1
Total		13,207,068		78.6%	21.4%	10,377,968	2,829,100

Adrian ÇELA
Administrator

OPERATORI I SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE SH.A

OSHEE sh.a.

RAPORTI FINANCIAR (paraparak) VITI 2017

PËRMBAJTJA:

A.	PASQYRAT FINANCIARE	3
1.	PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR.....	3
2.	PASQYRA E FITIM/HUMBJES DHE TË ARDHURAVE GJITHPËRFSHIRËSE.....	4
3.	PASQYRA E FLUKSEVE MONETARE	5
4.	PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL.....	6
Datë 31 Dhjetor 2017.....		6
B.	VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM	7
a)	Ndryshime në Statusin Ligjor të Shoqërisë	7
b)	Gjykimet në lidhje me Parimin e vijimësisë.....	8
C.	SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE	12
1.	Aktive Afatgjata	12
2.	Aktive Afatshkurtëra	14
a)	Inventarët	14
b)	Llogari të Arkëtueshme Tregtare.....	14
c)	Llogari të Arkëtueshme të Tjera.....	15
d)	Mjete Monetare.....	15
3.	Kapitali.....	15
4.	Detyrimet.....	16
5.	Të Ardhurat	18
6.	Shpenzimet për Energji dhe Transmetim	19
7.	Shpenzimet Operacionale	19
8.	Shpenzimet e Amortizimit dhe Provigjonimet.....	21
9.	Shpenzimet Financiare dhe Tatim Fitimi.....	21
D.	KONKLUZIONE DHE PERSPEKTIVA	23

DEPARTAMENTI EKONOMIK
A. PASQYRAT FINANCIARE

1. PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR

		<u>31.12.2016</u>	<u>31.12.2017</u>
AKTIVET	Shënime	61,959,165	69,762,226
Aktive Afatgjata		29,886,130	37,107,244
Aktive Afatgjata Materiale	1	29,372,182	36,413,547
Aktive Afatgjata Jo Materiale		512,341	692,237
Aktive Financiare		1,606	1,461
Tatimi i shtyrë		-	-
Aktive Afatshkurtra	2	32,073,035	32,654,982
Inventaret		4,468,808	6,178,506
Llogari të Arkëtueshme tregtare neto		20,515,613	21,057,479
Të tjera të Arkëtueshme neto		348,719	862,067
Mjete monetare dhe ekuivalente		1,289,996	1,267,387
Mjete monetare të ngurtësuara		5,449,899	3,289,543
KAPITALI DHE REZERVAT	3	(35,537,506)	(31,368,459)
Kapitali Aksionar		30,083,349	30,083,349
Rezerva rivlerësim asetesh		1,513,463	1,513,463
Rezerva të tjera		2,916,011	2,916,011
Humbje të akumuluar		(88,770,269)	(64,667,681)
Të ardhura neto vjetore		18,719,939	(1,213,601)
DETYRIMET	4	97,496,671	101,130,685
Detyrimet afatgjata		11,119,314	10,994,137
Huatë afatgjata neto		11,119,314	10,994,137
Provizione		-	-
Detyrimet afatshkurtra		86,377,357	90,136,548
Llogaritë e pagueshme Tregtare		45,817,313	57,310,569
Detyrimet për taksa dhe sig. shoq.		8,195,822	6,117,019
Tatimi mbi të ardhurat		5,442,125	858,265
Pjesa afatshkurtër e huave afatgjata		6,624,743	7,705,076
Huatë afatshkurtra		-	-
Detyrime të tjera afatshkurtra		14,673,562	12,521,345
Provizione		5,623,792	5,624,274
TOTALI I KAPITALIT DHE DETYRIMEVE		61,959,165	69,762,226

DEPARTAMENTI EKONOMIK

2. PASQYRA E FITIM/HUMBJES DHE TË ARDHURAVE GJITHPËRFSHIRËSE

	2016	2017
Të ardhurat	51,808,210	53,543,116
Të ardhura të tjera	10,215,645	1,422,621
Të ardhurat operative	62,023,855	54,965,737
Energjia e blerë	(21,737,924)	(34,986,109)
Tarifa e transmentimit	(3,927,551)	(4,700,225)
Lëndë e parë dhe materiale konsumi të përdorura	(976,205)	(929,675)
Shpenzime për personelin	(5,001,793)	(6,183,331)
Zhvlerësimi dhe amortizimi	(1,835,305)	(2,492,057)
Shpenzime të tjera	(6,348,813)	(6,008,899)
Shpenzimet operative	(39,827,591)	(55,300,295)
Fitim / Humbje Operative	22,196,264	(334,559)
Të ardhura financiare	393,223	891,190
Shpenzime financiare	(1,233,113)	(1,003,536)
Shpenzime financiare Neto	(839,890)	(112,346)
Humbja para taksave	21,356,374	(446,905)
Shpenzim tatim fitimi	(2,636,434)	(766,696)
Humbja e vitit ushtrimor	18,719,939	(1,213,601)
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse	1,513,463	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse	20,233,402	(1,213,601)

DEPARTAMENTI EKONOMIK
3. PASQYRA E FLUKSEVE MONETARE

CASH FLOW (000 / Lekë)	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor '17 Akumulativ
Aktivite Operative		
Humbje para tatim fitimit	21,356,374	(446,905)
<i>Korrigjuar për:</i>		
Zhvlërim, amortizim, nxjerrje jashtë përdorimit	(10,276,194)	2,492,057
(Fitimet) Humbje nga kursi i këmbimit valutor, neto	171,975	(403,826)
Shpenzime interesi, të ardhura nga interesi	320,360	246,882
Vlerësimi i rezervave, provigjoneve dhe korrigjime të tjera	(7,688,213)	1,112,096
<i>Ndryshime në kapitalin qarkullues:</i>		
Llogari të arkëtueshme	(4,953,658)	(1,653,481)
Materiale dhe furnizime	(2,005,037)	(1,709,698)
Llogari të ngurtësuar	(5,449,899)	(3,289,543)
Aktive të tjera afatshkurtëra	8,391	(513,348)
Llogari të pagueshme dhe detyrime të tjera	4,896,392	7,262,237
Flukset e parasë së gjeneruar nga aktiviteti operativ	(3,619,511)	3,096,471
Tatim mbi fitimin i paguar	(1,305,292)	(5,350,556)
Interesi i paguar	(399,242)	(268,941)
Interesi i arkëtuar	78,882	22,058
Flukset e parasë neto gjeneruar nga aktiviteti operativ	(5,245,163)	(2,500,967)
Aktiviteti investues		
Shtesa në aktivet afatgjata materiale dhe në aktive të tjera afatgjata	2,001,040	(9,398,078)
Arkëtimi nga shitja e aktiveve afatgjata		
Shtesa në aktivet afatgjata jomateriale	(155,220)	(315,238)
Arkëtim nga pagesat e huave	630	146
Flukset e parasë neto përdorur në aktivitetet investuese	1,846,450	(9,713,171)
Aktiviteti financues		
(Pagesat)/arkëtimet neto nga huatë	(1,757,984)	955,155
Flukset monetare neto nga aktivitetet financuese	(1,757,984)	955,155
Efekt neto nga ndryshimi në kursin e këmbimit	(171,975)	403,826
Rritje/ (Rënie) e Humbjeve të Akumuluar		5,382,648
Rritja / (ulja) neto në mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre.	(5,328,672)	(5,472,508)
Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre në fillim të periudhës	6,618,667	6,739,895
Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre në fund të periudhës	1,289,996	1,267,387

4. PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL

Datë 31 Dhjetor 2017

Kapitali Aksionar (000 / Lekë)	Kapitali Aksionar	Rezerva të tjera	Humbjet e Akumuluar	Total
Balanca në 31 Dhjetor 2016	30,083,349	2,916,011	(70,050,330)	(37,050,969)
Ndryshime në politikën kontabile	-	1,513,463	-	1,513,463
Rezultate financiare të viteve të mëparshme	-	-	-	-
Balanca e re	30,083,349	4,429,474	(70,050,330)	(35,537,506)
Ndryshime në Kapital	-	-	-	-
Zvogëlim në aksione	-	-	-	-
Rezultate financiare të viteve të mëparshme	-	-	-	5,382,648
Humbja për periudhën Dhjetor 2017	-	-	(1,213,601)	(1,213,601)
Balanca në 31 Dhjetor 2017	30,083,349	4,429,474	(71,263,930)	(31,368,459)

DEPARTAMENTI EKONOMIK

B. VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM

a) Ndryshime në Statusin Ligjor të Shoqërisë

Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a (ose "Shoqëria") zotëron liçencën e vetme të shpërndarjes së energjisë elektrike në Shqipëri.

Struktura organizative e shoqërisë gjatë vitit 2017, ka qenë e organizuar si vijon:

- Divizioni Tregtar (DT),
- Divizioni i Shpërndarjes (DSH)
- Divizioni i Administrimit të Përgjithshëm (DAP). (Departamenti Ekonomik është pjesë e strukturës së DAP).

Gjithashtu Shoqëria përbëhet nga 11 Drejtori Rajonale që administrojnë shpërndarjen, shitjen dhe arkëtimin e energjisë elektrike në tensionin e mesëm dhe të ulët, si dhe nga Drejtoria e Tensionit të Lartë me 4 Drejtori Rajonale të Tensionit të Lartë (DTL).

Shoqëria u krijua si shoqëri Aksionere më 19 Qershor 2007, duke u bazuar në Vendimin nr. 862 të Këshillit të Ministrave, të datës 20 Dhjetor 2006. Kjo Shoqëri u themelua si rezultat i ndarjes nga Korporata Elektroenergjitike Shqiptare sh.a ("KESH" ose "Shoqëria Mëmë") dhe filloi aktivitetin e saj operativ që prej 1 Janarit 2007.

Më 29 Maj 2009, 76% të aksioneve të Shoqërisë kaluan në pronësi të shoqërisë CEZ a.s, me seli në Duhova 2/1444, 14074, 4 Pragë, Republika Çeke ndërsa 24% të aksioneve mbetën në pronësi të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

Në 21 Janar 2013, Shoqëria u vendos në administrim të përkohshëm nga shteti, me vendim të ERE Nr.4 datë 21.01.2013 " Mbi heqjen e liçencës së shpërndarjes së energjisë Shoqërisë CEZ a.s".

Me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE, nr.63 dt.17.07.2014 dhe rregjistrimin e tij në QKR, Shoqërisë ju ndryshua emri i rregjistruar duke filluar nga data 23.07.2014, nga Cez Shpërndarje sha në Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sha me adresë: Rr. Andon Zako Çajupi, Pallati Conad, Kati 3, Tiranë.

Me Ligjin nr.114/2014 dt.31.07.2014, është miratuar marrëveshja për zgjidhjen me mir 137kuptim ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Shoqërisë CEZ AS. Është vendosur transferimi i aksioneve nga CEZ AS shtetit shqiptar, anulimi i të ardhurave të arkëtueshme (detyrimeve) dhe shuma e zgjidhjes me pajtim (detyrimi i ri ndaj CEZ AS).

Bordi i Komisionerëve të ERE, me vendim nr.98 dt.27.10.2014, ka vendosur përfundimin e administrimit të përkohshëm i Shoqërisë.

Më datën 23.10.2014, Ministri i MZHETS, me cilësinë e Aksionerit të vetëm, me Urdhërin nr.454, ka urdhëruar rregjistrimin e 100 % të aksioneve të Shoqërisë në pronësi të shtetit.

Shoqëria ka Statusin e saj, ku është përcaktuar vendimmarrja dhe drejtimi sipas sistemit me dy nivele. Organet drejtuese janë : Asambleja e Përgjithshme, Këshilli Mbikqyrës dhe Administratori.

DEPARTAMENTI EKONOMIK

Këshilli Mbikqyrës me Vendimin nr.1 dt.28.10.2014, ka vendosur Z. Ilir Bejtja Kryetar të këtij këshilli.

Me vendimin nr.9 datë 01.12.2014, Këshilli Mbikqyrës ka emëruar z.Adrian Çela Administrator të shoqërisë OSHEE sha.

Duke filluar nga data 6 Qershor 2016, aksionet e shoqërisë janë rregjistruar në pronësi të Ministrisë Energjisë dhe Industrisë si përfaqësuese e pronarit shtet, transferuar kështu nga ish aksionari Ministria e Ekonomisë Tregëtisë dhe Energjitikës.

Nuk kanë ndodhur ndryshime të rëndësishme në statusin juridik të shoqërisë gjatë vitit 2017, ndërsa ndarja përfundimtare e shoqërisë sipas kërkesave të ligjit 43/2015 “Për sektorin e Energjisë Elektrike” pritet të ndodhë brenda vitit 2019.

Shoqëria e ka vend-ndodhjen në Shqipëri. Bulevardi “Gjergj Fishta”, Ndërtesa Nr. 88, H.1, Njësia Administrative Nr. 7, 1023, Tiranë, (adresa e regjistruar në QKR).

b) Gjykimet në lidhje me Parimin e vijimësisë

Pasqyrat financiare 2017 janë përgatitur sipas parimit të vijimësisë, që do të thotë se veprimtaria ekonomike e OSHEE do të ketë vijimësi, në përputhje me përshkrimet e zbatimit të këtij parimi në Standartin Ndërkombëtar të Kontabilitetit (SNK) Nr.1 Paragrafi 25 si dhe Standardin Kombëtar të kontabilitetit (SKK) Nr.1 paragrafi 46-47.

Siguria në vijimësinë e aktivitetit të shoqërisë në vitin 2018 dhe në vazhdim mbështetet në:

- Pozita e favorshme (monopol) në tregun e energjisë.

OSHEE vazhdon të ruajë pozitë monopol në tregun e energjisë, pozitë e cila për periudhën në vazhdim sanksionohet edhe në ligjin Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë” datë 30.04.2015 i cili parashikon vazhdimin e aktivitetit të Operatorit të Shpërndarjes aksionet e të cilit zotërohen tërësisht nga shteti dhe për të cilin nuk ka plane afatshkurtëra dhe afatmesme privatizimi.

Bazuar në ligjin Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë” aktiviteti i shitjes së energjisë do të ndahet nga ai i shpërndarjes. Ndarja e aktiviteteve do të kryhet (bazuar edhe në konkluzionet paraprake të shoqërisë këshilluese për projektin e ndarjes së shoqërisë) duke u bazuar në pikën 3 të nenit 72 të ligjit e cila bazohet në një shoqëri vertikalisht të integruar e cila do të zotërojë aktivitete të ndara. Hapja e tregut dhe humbja e monopolit të OSHEE në aktivitetin e shitjes së energjisë do të bëhet hap pas hapi në përmbushje të kërkesave të ligjit dhe do të kërkojë një periudhë të paktën 2 vjeçare 2018 - 2019.

- Rezultati ekonomik i aktivitetit dhe përmirësimi i pozicionit financiar të OSHEE

Aktiviteti ekonomik i OSHEE ka shënuar përmirësim të jashtëzakonshëm në periudhën 2015 – 2017, duke kaluar nga humbja e vazhdueshme që prej krijimit të shoqërisë në vitin 2007 në rezultat financiar pozitiv që i ka tejkalluar të gjitha pritshmëritë.

DEPARTAMENTI EKONOMIK

Viti që u mbyll 2017 ishte viti i vështirësive të jashtëzakonshme financiare të sistemit energjitik dhe sidomos për OSHEE mbi të cilën rëndoi pjesa më e madhe e pasojave për shkak të faktorëve si më poshtë:

- a) Për shkak të thatësisë KESH dhe HEC-et lokale nuk mundën të plotësojnë sasinë e planifikuar dhe të kontraktuar në bazë të kontratës së furnizimit dhe OSHEE u detyrua të blejë në tregun e hapur (import) sasinë e nevojshme për mbulimin e nevojave të konsumatorëve. Sasia e energjisë së furnizuar nga KESH dhe HEC-et ishte 1,370 Gwh më e vogël se sa sasia e energjisë që u planifikua në fillim të vitit të cilën OSHEE e bleu në tregun e hapur me çmim mesatar 8.9 Lekë/Kwh nga 3 Lekë/Kwh që ishte planifikuar.
- b) Rritja e konsumit të energjisë tej parashikimit detyroi blerjen e energjisë tej planifikimit për 406 Gwh.
- c) Rritja e çmimit të importit për rreth 38% nga 6.42 Lekë/Kwh në 8.9 Lekë/Kwh

Si rezultat i faktorëve të mësipërm OSHEE u detyrua të shpenzonte për blerjen e energjisë dhe transmetimin **14.2 Miliard Lekë** më shumë se sa shpenzimi i planifikuar ose rreth 106.7 Milion EURO. Si rezultat i rritjes së jashtëzakonshme të shpenzimeve për energji OSHEE do të mbyllë vitin financiar 2017 me humbje prej rreth 1.2 miliard Lekë.

Ndikimi negativ i Rritjes së shpenzimeve të blerjes së energjisë në rezultatin e vitit 2017 u zvogëlua nëpërmjet masave të marra në përmirësim të treguesve ekonomiko-financiare, të cilat synojnë:

- Zvogëlim i humbjeve jo-teknike nëpërmjet forcimit të kontroleve në rrjet, ndërprerjes së lidhjeve të paligjshme dhe vendosjes para ligjit të abuzuesve si dhe nëpërmjet investimeve që përmirësojnë teknologjinë dhe organizimin e punës.
- Zvogëlimin e humbjeve teknike nëpërmjet rritjes së efijencës së rrjetit nga përmirësimi i mirëmbajtjes dhe investimeve të reja.
- Rritjen e arkëtimit nëpërmjet politikave të ristrukturimit të borxhit dhe përmirësimit të marrdhënieve me klientët duke përmirësuar shërbimin dhe rritur besimin reciprok.
- Rritjes së efijencës së punës së punonjësve të shoqërisë nëpërmjet masave organizative, rritjes së kualifikimit dhe motivimit të punonjësve.
- Përmirësimit të cilësisë së furnizimit me energji elektrike nëpërmjet investimeve në teknologji të përparuara që përmirësojnë treguesit teknikë të furnizimit.
- Zvogëlimin të kohës së ndërprerjeve teknologjike dhe të kohëzgjatjes së riparimit të defekteve në rrjet.

Më poshtë treguesit kryesorë të performancës periudhës 2016 – 2017:

DEPARTAMENTI EKONOMIK

000/Lekë	Përshkrimi	Realizimi	Realizimi
		Dhjetor 2017	Dhjetor 2016
Të ardhurat	Te ardhura nga Shitja e energjisë	52,893,726	51,267,345
	Te ardhur nga kamatëvonesat	1,104,307	1,677,087
	Te ardhura nga Shpërndarja (Lidhje të reja)	649,390	540,865
	Te tjera	318,314	207,033
	Gjithsej	54,965,737	53,692,330
Shpenzimet	Shpenzime Energji dhe Transmetim	39,686,335	25,665,476
	Shpenzime Operative	11,392,157	12,094,938
	Provizione	1,729,748	(8,942,259)
	EBITDA	2,157,498	24,874,175
	Amortizimi	2,492,057	2,678,027
	Shpenzime Financiare	112,346	839,890
	Tatim Fitimi	766,696	2,636,434
	Gjithsej	56,179,337	34,972,506
REZULTATI I AKTIVITETIT		(1,213,601)	18,719,824

Mbështetja e Qeverisë

Për kalimin e situatës së vështirë të krijuar gjatë vitit 2017 me likuiditetin në OSHEE, ajo u ndihmua nga Qeveria Shqiptare e cila miratoi një kredi afatshkurtër prej 1 miliard Lekë dhe një tjetër afatgjatë prej 1.5 miliard Lekë mbështetur në Aktin Normativ Nr.2 datë 16.08.2017 si dhe në VKM Nr.539 datë 09.10.2017.

Menaxhimi i shoqërisë i ka kërkuar mbështetjen e Qeverisë Shqiptare për përfshirje më të madhe të Shoqërisë në Ligjin për amnistinë fiskale që u zbatua gjatë vitit 2017 nga i cili OSHEE përfitoi një shumë rreth 5.4 miliard Lekë.

Me vendimin Nr. 171, datë 25 shkurt 2015 Këshilli i Ministrave, Qeveria aprovoi Planin për Rimëkëmbjen Financiare në Sektorin e Energjisë, me synimin për të përmirësuar arkëtimet, flukset monetare, pakësuar humbjet dhe siguruar furnizim të qëndrueshëm me energji në mënyrë që të arrihet qëndrueshmëria dhe të rikthehet besimi në sektorin energjetik. Qeveria është angazhuar për të siguruar bashkëpunimin e Ministrisë së Brëndshme dhe të gjithë ministrive të tjera të rëndësishme dhe institucioneve publike për implementimin e planit.

Sipa këtij plani brenda një periudhe 5 vjeçare kapitali negativ i shoqërisë do të ulej në 43 miliardë Lekë. Në fakt rezultatet paraprake të vitit 2017 tregojnë se kapitali negativ i shoqërisë është ulur në 31.4 miliard Lekë që do të thotë disa vjet më parë se parashikimi.

Tashmë po punohet për përditesimin e Planit të Rimëkëmbjes së Sektorit të Energjisë Elektrike që Qeveria Shqiptare miratoi me vendim të Këshillit të Ministrave nr.171 date 25.02.2015, në përputhje me arritjet e periudhës 3 vjeçare në zbatim të tij, ku fokusi kryesor do të vazhdojë të jetë

DEPARTAMENTI EKONOMIK

përmirësimi i treguesve të performancës së OSHEE-s, reduktimi i humbjeve teknike dhe joteknike dhe rritja e normës së arkëtimit.

Zbatimi në praktikë i ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë” datë 30.04.2015 është duke u shoqëruar me përgatitjet për ndarjen përfundimtare të shoqërisë ku aktiviteti i shpërndarjes do të ndahet jo vetëm ligjërisht sikurse është planifikuar në ligj në fillim të vitit 2018 por edhe duke plotësuar të gjitha marrëveshjet e funksionimit të hallkave administrative që do të krijohen.

Në zbatim të ligjit “Për Sektorin e Energjisë” prej datës 1 Korrik 2016 OSHEE vazhdon të kryejë aktivitetin e Furnizuesit Universal si dhe rolin e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit të licensuar nga ERE.

Menaxhimi i likuiditetit

Në përputhje dhe zbatim të kushteve të vendosura nga marrëveshja e kredisë me Bankën Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (BNRZH) dhe kushteve të përcaktuara në Planin për Rimëkëmbjen Financiare në Sektorin e Energjisë Elektrike, me gjithë situatën e vështirë të krijuar për shkaqe të përmendura më lartë, gjatë vitit 2017 OSHEE duhet të shlyente 95% të energjisë së blerë nga KESH-i dhe të shërbimeve të transmetimit të marra nga OST-ja. Gjatë vitit 2017, Shoqëria pagoi 102% të faturave vjetore të blerjeve nga KESH-i dhe 98% nga OST-ja. Sipas marrëveshjes shuma gjatë vitit në vazhdim 2018 do të jetë në 100% të faturave vjetore duke u rritur në 105% në vitet e mëvonshme.

Detyrimet sipas marrëveshjes me CEZ a.s. janë përmbushur me pagesën e rradhës prej rreth 21 milion Euro për vitin 2017 dhe në llogarinë escrow është duke u akumuluar shuma e nevojshme për pagesën e vitit 2018 në muajin Gusht.

Pagesat ndaj furnitorëve të tjerë për shërbime dhe mallra të aktivitetit të Shoqërisë gjatë vitit 2017 janë shlyer në kohë sipas datëpagesës së përcaktuar në kontratë.

Rritja në vlera të mëdha e investimeve ka çuar në rritjen e detyrimit afatshkurtër për këta investitorë me rreth 1.2 mld Lekë pagesa e të cilave është brënda afateve ligjore të vendosura në kontratat përkatëse.

Drejtimi e njëj pasigurinë mbi aftësinë e Shoqërisë për të përmbushur kërkesat e saj të financimit dhe shlyerjen e pagesave në kohën e duhur. Megjithatë, siç përshkruhet më sipër, organet drejtuese të shoqërisë kanë sigurinë e arsyeshme se Shoqëria ka burime dhe mbështetje të mjaftueshme nga qeveria për të vazhduar aktivitetet operative për të ardhmen.

Masa të tjera

Duhet theksuar se rritja e jashtëzakonshme e investimeve është arritur duke u mbështetur tërësisht rezultatet pozitive të aktivitetit të shoqërisë. Marrëveshja e nënhuasë e nënshkruar ndërmjet Qeverisë Shqiptare dhe OSHEE në Dhjetor 2014 për 73 milion Euro që do të përdoren për investime (në kuadër të marrëveshjes së Qeverisë Shqiptare me Bankën Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD) prej 112 milion Euro) është lëvruar vetëm pjesërisht ose vetëm rreth 21.8 milion Euro të cilat janë përdorur për prokurime në blerjen e materialeve për investime.

DEPARTAMENTI EKONOMIK

Investimet pjesë e projektit të kësaj marrveshje pritet të jenë shumë më të larta në vitin 2018 – 2019 kur mbaron afati i disbursimit të kësaj kredie.

Në përfundim:

Vijimësia e aktivitetit të Shoqërisë OSHEE sha, për rëndësinë që ajo ka në shpërndarjen e energjisë elektrike por edhe bazuar në përmirësimin e dukshëm të treguesve kryesorë, në masat e marra nga Administrimi e në veçanti nga Qeveria, garantojnë vazhdimësinë e aktivitetit të shoqërisë.

C. SHËNIME PËR PASOQRAT FINANCIARE

Vlera e asetëve gjatë vitit 2017 u rrit për 7.2 miliard Lekë e cila lidhet kryesisht me Investimet të cilat ishin 9.4 miliard Lekë ndërkohë që amortizimi i vitit 2017 ishte rreth 2.4 miliard Lekë. Gjendja e inventareve për shkak të materialeve të blera nga fonde të Bankës Botërore u rrit për 1.7 miliard Lekë.

Mjetet monetare në fund të vitit u ulën për 2.2 miliard Lekë.

1. Aktive Afatgjata

Vlera e Aktiveve Afatgjata në fund të vitit 2017 paraqitet në tabelën si vijon:

	OSHEE Asete (000/ Lekë)	Aktual	Aktual	Investimet
		31.12.2016	31.12.2017	'12/ 2017
1	Të tjera AAGJ - JM	290,355	291,163	809
	Software	169,848	275,398	105,550
	AAGJ - JM në proçes	203,825	412,705	208,880
	Nën total aktive jo materiale	664,028	979,266	315,238
VLERA BRUTO E ASETEVE	Toka	1,035,447	1,035,447	-
	Përmirësimi Toka	369,108	369,108	-
	Ndërtesa dhe konstruksione	2,602,892	2,852,328	249,436
	Makineri dhe pajisje	29,344,289	31,650,175	2,305,886
	Mjete transporti	313,086	313,086	-
	Pajisje Zyre	126,905	128,879	1,973
	Pajisje IT	945,888	1,184,791	238,904
	Llogari teknike asete	-	1,917,298	1,917,298
	AAGJ - Materiale në proçes	4,846,388	9,530,969	4,684,581
	Nën total aktive materiale	39,584,003	48,982,081	9,398,078
Aktive Afatgjata Gjithsej	40,248,031	49,961,348	9,713,317	

DEPARTAMENTI EKONOMIK

Rezultatet pozitive të arritura nga shoqëria si dhe ndihma Qeveritare në kushtet e vështirësive të mëdha për shkak të thatësisë bënë të mundur që investimet të realizohen përgjithsisht sipas plani të miratuar duke theksuar se Kredia e Levruar nga Banka Botërore nuk është akoma në proces kapitalizimi.

Një pjesë e investimeve janë akoma në proces kapitalizimi (proces formal i plotësimit të dokumentacionit) që do të përfundojë brenda 3 mujorit të parë në fund të të cilit Pasqyrat Financiare do të dorëzohen në organet tatimore sipas ligjit.

Vlera e Amortizimit të Aktiveve Afatgjata në fund të vitit 2017 paraqitet në tabelën si vijon:

OSHEE Asete (000/ Lekë)		Aktual	Aktual	Amortizimi
		31.12.2016	31.12.2017	2017
AMORTIZIMI	2 Amortizimi i akumuluar - AQTP	111,746	204,736	92,991
	Amortizimi i akumuluar - Software	39,941	82,293	42,352
	Nëntotal amortizim	151,687	287,030	135,343
	Amortizimi i akumuluar - Përmirësim i tokave	26,267	52,533	26,267
	Amortizimi i akumuluar - Ndërtesa dhe konstruksione	100,158	200,511	100,353
	Amortizimi i akumuluar - Makineri dhe pajisje	9,308,339	11,376,286	2,067,947
	Amortizimi i akumuluar - Mjeteve të transportit	132,716	192,036	59,320
	Amortizimi i akumuluar - Pajisjet e Zyrave	67,276	78,268	10,992
	Amortizimi i akumuluar - Pajisje IT	577,064	668,899	91,835
	Nëntotal amortizim	10,211,820	12,568,534	2,356,714
Amortizim Total	10,363,507	12,855,564	2,492,057	

Vlera e Aktiveve Afatgjata Neto në fund të vitit 2017 paraqitet në tabelën si vijon:

OSHEE Asete (000/ Lekë)		Aktual	Aktual
		31.12.2016	31.12.2017
VLERA NETO E ASETEVE	3 Të tjera AAGJ - Jo materiale	178,609	86,427
	Software	129,907	193,105
	AAGJ - Jo materiale në proces	203,825	412,705
	Nën total asetë jo materiale Neto	512,341	692,237
	Toka	1,035,447	1,035,447
	Përmirësimi Toka	342,841	316,574
	Ndërtesa dhe konstruksione	2,502,734	2,651,818
	Makineri dhe pajisje	20,035,950	20,273,889
	Mjete transporti	180,370	121,050
	Pajisje Zyre	59,629	50,610

DEPARTAMENTI EKONOMIK

Pajisje IT	368,823	515,892
AAGJ - Materiale në proces	4,846,388	9,530,969
Llogari teknike asete	-	1,917,298
Nën total asete materiale Neto	29,372,182	36,413,547
Asete Totale Neto	29,884,524	37,105,784

Aktivitet Financiare në pasqyrën e Pozicionit Financiar lidhen kryesisht me Kredi për shtëpi dhënë punonjësve në vitet 2006 – 2008.

2. Aktive Afatshkurtëra

a) Inventarët

Vlera e Llogarive Inventariale në fund të vitit 2017 paraqitet në tabelën si vijon:

OSHEE INVENTARI (000/ LEKE)	Aktual	Aktual	Ndryshimi
	31.12.2016	31.12.2017	'12/ 2017
Llogari teknike materialet Elektrike	-	(6,663)	(6,663)
Nafta dhe materiale të tjera të djegshme	3,991	16,392	12,401
Materiale konsumi	4,682,680	6,387,001	1,704,320
Llogari Teknike - për Materialet në Magazinë	-	(311)	(311)
Rënie në vlerë të inventarve	(218,622)	(218,622)	-
Llogari teknike materiale për çelje	(241)	(241)	-
Diferenca inventariale	999	950	(49)
Total	4,468,808	6,178,506	1,709,698

Shtesa e inventareve ka ardhur nga materialet e blera për investime me kredi të Bankës Botërore.

b) Llogari të Arkëtueshme Tregtare

Vlera e Llogarive të Arkëtueshme Tregtare në fund të vitit 2017 paraqitet në tabelën si vijon:

OSHEE Llogari të Arkëtueshme Tregtare (000/Lekë)	Aktual	Aktual	Ndryshimi
	31.12.2016	31.12.2017	'12/ 2017
Klientë Familjarë	37,587,032	36,280,066	(1,306,966)
Klientë Privat	26,972,300	27,939,010	966,710
Klientë Publik Buxhetor	799,405	1,030,092	230,688
Klientë Publik Jo Buxhetor	7,302,939	9,068,064	1,765,126
Total	72,661,675	74,317,233	1,655,557

DEPARTAMENTI EKONOMIK

Zbritje për Llogaritë e arkëtueshme - Klientë Familjarë	21,872,921	20,727,238	(1,145,684)
Zbritje për Llogaritë - Klientë Privat	23,105,064	23,604,529	499,465
Zbritje për Llogaritë - Institucione Publike Buxhetore	533,257	708,253	174,996
Zbritje për Llogaritë - Institucione Publike Jo Buxhetore	6,493,497	8,076,335	1,582,838
Total	52,004,740	53,116,354	1,111,615

Klientë nga aktivitete të tjera	(141,322)	(143,399)	(2,077)
---------------------------------	-----------	-----------	---------

Llogari të Arkëtueshme Tregtare Neto	20,515,613	21,057,479	541,866
---	-------------------	-------------------	----------------

c) Llogari të Arkëtueshme të Tjera

Vlera e Llogarive të Arkëtueshme të Tjera në fund të vitit 2017 paraqitet në tabelën si vijon:

OSHEE Llogari të Arkëtueshme të Tjera (000/Lekë)	Aktual	Aktual	Ndryshimi
	31.12.2016	31.12.2017	'12/2017

Llogari të Arkëtueshme të Tjera	5,551,697	6,065,045	513,348
---------------------------------	-----------	-----------	---------

Zbritje për Llogaritë e Arkëtueshme të Tjera	5,202,978	5,202,978	-
--	-----------	-----------	---

Llogari të Arkëtueshme të Tjera Neto	348,719	862,067	513,348
---	----------------	----------------	----------------

Vlera e llogarive të arkëtueshme është trashëguar nga viti 2012 si të Arkëtueshme për efekt të ligjit për Invaliditetin si dhe nga marrëdhënie me KESH.

d) Mjete Monetare

Vlera e Llogarive të Mjeteve Monetare në fund të vitit 2017 paraqitet në tabelën si vijon:

OSHEE BILANCI (000 / Lekë)	Aktual	Aktual	Ndryshimi
	31.12.2016	31.12.2017	31.12.2018
Mjete monetare dhe ekuivalente	1,289,996	1,267,387	(22,609)
Mjete monetare të ngurtësuar	5,449,899	3,289,543	(2,160,356)

3. Kapitali

Kapitali negativ i shoqërisë do të ketë një përmirësim prej rreth 4.2 miliard Lekë në mbyllje të Pasqyrave Financiare për vitin 2017.

DEPARTAMENTI EKONOMIK

Humbja financiare e vitit 2017 do të ketë një efekt negativ në Kapitalin e OSHEE prej 1.2 miliard Lekë.

Falja e detyrimeve tatimore të viteve të mëparshme do të ketë ndërkohë një efekt pozitiv prej rreth 5.4 miliard Lekë. Detajimi i faljes së detyrimeve tatimore paraqitet në tabelën më poshtë:

FALJE TATIMORE 2011-2014

Tatim mbi Vlerën e Shtuar	1,105,914,179
Tatim Fitimi	4,276,366,443
Tatim në Burim	1,308
Sigurime Shoqërore	366,255
TOTAL	5,382,648,185

4. Detyrimet

Rritja totale e detyrimeve prej 3.6 miliard ose 3.7 % ka ardhur si pasojë e mosplotësimit të furnizimit të sasisë së planifikuar të energjisë nga KESH për shkak të thatësisë e cila detyroi OSHEE të rrisë furnizimin nga Tregu i Lirë me energji të importuar në rritje të detyrimeve ndaj furnitorëve. Për shkak të kësaj gjëndje dhe mungesës së likuiditetit OSHEE u detyrua të merrte kredi akorduar nga Qeveria Shqiptare.

Një analizë e detajuar e detyrimeve duke i grupuar ato sipas furnitorëve kryesorë paraqitet në tabelën si më poshtë:

Tabela e detyrimeve

(në Lekë)

Nr	Përshkrimi i detyrimit	Detyrimet më 31.12.2016	Detyrimet më 31.12.2017
1	Shuma e Detyrimit ndaj KESH sha	56,080,889,538	53,720,370,262
	Detyrim për transferim Asete KESH	17,400,413	17,400,413
	Për energjinë elektrike	32,320,766,949	30,653,180,184
	Për energjinë elektrike (fatura të papranuara)	12,454,258,692	12,452,096,503
	Kredi Afatgjatë	11,288,463,484	10,597,693,162
2	Shuma e Detyrimit ndaj OST sha	10,914,928,260	11,917,705,362
	Transmetime energji elektrike	8,062,971,960	9,081,741,453
	Transmetime energji elektrike (fatura të papranuar)	498,180,057	482,187,667
	Penalitete për moslikujdim fature	2,353,776,242	2,353,776,242

DEPARTAMENTI EKONOMIK

3	Furnitorë për energji HEC	890,747,845	1,898,549,108
4	Furnitorë për import energjie	866,496,719	8,437,626,590
	Për fatura të pranuar	866,496,719	8,437,626,590
5	Detyrim ndaj CEZ AS (Marrevëshja)	5,463,510,763	2,737,129,445
6	Kredi Banka Botërore (Hua Afatgjatë IBRD Pr. RE)	992,082,797	2,864,389,911
7	Hua Ministria e Financave	-	2,500,000,000
	Hua Afatgjatë Ministria e Financave nr.14394	-	1,500,000,000
	Hua Afatshkurtër Ministria e Financave nr.14394.1	-	1,000,000,000
8	Shuma e Detyrimit ndaj Posta Shqiptare sha	1,102,029,819	1,307,436,745
	Posta - Detyrim për Fatura të pranuar	769,983,826	1,030,684,076
	Posta -Fatura të Përlllogaritura	332,045,994	276,752,670
9	Detyrime të tjera	7,524,869,976	8,526,810,780
10	Detyrime ndaj Tatimeve	13,661,115,504	7,220,666,835
	TOTALI	97,496,671,221	101,130,685,040

Duke analizuar të dhënat sipas tabelës më sipër:

- Detyrimet ndaj KESH janë ulur për 2.35 miliard Lekë. Detyrimi i OSHEE për pagesat ndaj KESH sipas Planit të Rimëkëmbjes ishte sa 95% të faturave koherente ndërsa janë paguar 102% duke ndikuar në uljen e përgjithëshme të detyrimeve.
- Detyrimet vjetore ndaj OST janë paguar 98% ndërkohë që detyrimi sipas Planit të Rimëkëmbjes ishte të paguhej 95% e faturave vjetore.
- Rritja prej rreth 1 miliard Lekë në fund të 2017 ndaj shoqërive të HEC-eve private lidhet me rritjen e prodhimit të tyre në muajt e fundit të vitit 2017 prej rreshjeve të shtuara, faturime të cilat janë brënda afatit të kontraktuar të pagesave.
- OSHEE si pasojë e thatësirës u detyrua të blejë sasi të mëdha energjie në Tregun e Importit, sikundër përmendëm më sipër, sidomos në pjesën e fundit të vitit të cilës i përket edhe rritja e detyrimeve për këta furnitorë prej rreth 7.6 miliard Lekë. Kjo rritje u ndikua edhe nga rritja e çmimit të importit të energjisë elektrike dhe e gjithë sasia është brenda kushteve kontraktuale të pagesave për çdo furnitor.
- Në muajin Gusht OSHEE pagoi këstin e rradhës ndaj CEZ A.S sipas kushteve të kontratës prej 2.7 miliard Lekë.
- Kredia e lëvruar nga Banka Botërore ka vazhduar të lëvrohet për një shtesë prej 1.9 miliard Lekë gjatë vitit 2017.
- Për të bërë të mundur likuidimin në kohë të furnitorëve në fund të vitit 2017 për OSHEE u akordua një kredi me kushte të favorshme nga Qeveria Shqiptare nëpërmjet Ministrisë së Financave prej 2.5 miliard Lekë.

DEPARTAMENTI EKONOMIK

- h) Rritja e Detyrimeve të Tjera prej 1 miliard Lekë lidhet kryesisht me funitorë për investime të cilat nuk kanë ndaluar megjithë situatën e vështirë.
- i) Detyrimet tatimore janë ulur për 6.4 miliard Lekë, prej të cilave rreth 1.1 miliard Lekë janë pagesa vjetore të tatim fitimit ndërsa 4.3 miliard Lekë nga falja e detyrimeve tatimore.

5. Të Ardhurat

Sipas klasifikimit në analizën menaxheriale të Të Ardhurave 2017 krahasimi i tyre me vitin 2016 paraqitet në tabelën që vijon:

OSHEE PASH (000 / Lekë)	2016	2017
TE ARDHURA	53,692,330	54,855,837
Te Ardhura Kryesore	53,485,297	54,647,423
Te adhurat nga SHITJA	52,944,432	53,998,033
Konsumatorët Familjare	24,856,692	25,479,245
Konsumatorët Private	19,777,246	20,389,060
Konsumatorët Buxhetorë	2,909,154	2,933,577
Konsumatorët Jo Buxhetorë	3,724,254	4,091,844
<i>-Të ardhura nga Kamatëvonesat</i>	<i>1,677,087</i>	<i>1,104,307</i>
Të ardhura nga SHPËRNDARJA	540,865	649,390
Tarifë tension 35 kv Shpërndarje	-	-
Lidhjet e reja	540,865	649,390
Të Ardhura të Tjera	207,033	208,415

Të ardhurat janë rritur me 2.2% në krahasim me vitin 2016 ose 1.16 miliard Lekë.

Të ardhurat nga shitja e energjisë të cilat përbëjnë rreth 98% të totalit të të ardhurave u rritën 2% duke shënuar rritje në të gjitha grupet e konsumatorëve. Rritja e të ardhurave ka ardhur në pjesën më të madhe nga masat për ndërprerjen e lidhjeve të paligjshme dhe uljen e humbjeve si dhe si pasojë e rritjes së konsumit.

Ulja e pritshme e të ardhurave nga kamatëvonesat është pasojë e masave të marra për rritjen e arkëtimit koherente si dhe faljeve të aplikuar të kamatëvonesave në skemat e pagesave të ndërtuara për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura.

Të ardhurat nga lidhjet e reja u rritën me 20%.

DEPARTAMENTI EKONOMIK

6. Shpenzimet për Energji dhe Transmetim

OSHEE PASH (000 / Lekë)	2016	2017
Shpenzime Energjie	(25,665,476)	(39,686,335)
<i>Energji e Blerë</i>	<i>(21,737,924)</i>	<i>(34,986,109)</i>
E Importuar	(8,335,375)	(22,935,192)
Blerje nga KESH	(9,760,582)	(4,181,631)
Blerje nga HEC	(3,641,967)	(7,869,286)
<i>Tarifa e Transmetimit dhe Disbalancat</i>	<i>(3,927,551)</i>	<i>(4,700,225)</i>

Si pasojë e ndikimit të mosfurnizimit me energji nga KESH për shkak të thatësisë së jashtëzakonshme shpenzimet e blerjes së energjisë në vitin 2017 ishin rreth 61% më të larta se ato të vitit 2016 ose 13.2 miliard Lekë.

Sipas planit të miratuar për vitin 2017 OSHEE do të blinte rreth 764 Gwh energji në tregun e importit dhe në fakt u blenë 2,539 Gwh ose 1,775 Gwh më shumë duke shkaktuar rritje të ndjeshme të kostove dhe rënie të performancës financiare të shoqërisë, duke pasur parasysh edhe rritjen e ndjeshme të çmimit të energjisë në tregun e importit, i cili nga 6.4 Lekë/Kwh që ishte paraparë në planin e vitit 2017 u rrit në rreth 8.9 Lekë/Kwh.

Si pasojë e motit të nxehtë edhe shpenzimet për disbalancat u rritën ndjeshëm në tejkalim të kostove të buxhetuara.

7. Shpenzimet Operacionale

OSHEE PASH (000 / Lekë)	2016	2017
Shpenzime Operacionale	(12,094,938)	(11,392,157)
Lëndët e Para dhe të konsumueshme	(310,593)	(331,128)
Përfitime dhe Shpenzime për të Punësuarit	(5,001,793)	(6,183,331)
Mirëmbajtje	(1,357,737)	(1,494,738)
Penalitete, gjoba e dëmshpërblime	(2,875,653)	(828,462)
Reklamim dhe publicitet	(78,545)	(23,773)
Qera	(412,117)	(456,902)
Shërbimet Postare	(650,873)	(734,087)
Shpenzime të IT	(73,334)	(15,833)
Shpenzime Ligjore	(145,586)	(54,337)
Konsulencë dhe Auditim	(158,409)	(57,944)
Të tjera	(1,030,300)	(1,211,623)

DEPARTAMENTI EKONOMIK

Menaxhimi me efikasitet i shpenzimeve dhe ulja e Shpenzimeve Operacionale kanë qenë në qendër të vëmendjes së organeve drejtuese të Shoqërisë. Ulja e shpenzimeve ndikoi gjithashtu në përmirësimin e performancës së shoqërisë e cila si pasojë e rritjes së jashtëzakonshme të shpenzimeve të blerjes së energjisë rrezikonte të rezultonte me një humbje edhe më të madhe.

Në të gjitha zërat e shpenzimeve ka patur ulje të ndjeshme në krahasim me buxhetin e miratuar ndërsa në raport më vitin 2017 konstatojmë se:

- Shpenzimet për pagesat e punonjësve megjithëse ishin 4% më të ulta se ato të buxhetuar u rritën me 23% në krahasim me vitin 2016. Rritja e pagave të punonjësve prej rreth 38% u zbatua në muajin Gusht 2016 u bazua në VKM dhe pati një ndikim pjesor prej vetëm 5 muajsh në vitin 2016.
- Shpenzimet për Materialet me një kursim prej 20% në krahasim me buxhetin e miratuar kryesisht për shkak të nevojës së pajisjes së punonjësve me rroba pune, u rritën vetëm 6.6% në krahasim me vitin 2016.
- Shpenzimet për Mirëmbajten e rrjetit të transmetimit megjithëse rreth 10% më të larta se ato të vitit 2016 ishin 50% më të ulta se ato të buxhetuara.
- Shpenzimet për Penalitete dhe Gjoha ishin 71% më të ulta se ato të vitit 2016 me një kursim prej rreth 2 miliard Lekë.
- Rritja e shpenzimeve për Qeratë me rreth 11 % në krahasim me vitin 2016 megjithëse 6% më e ulët se sa ajo e planifikuar lidhet me qeratë e magazinave të reja për shkak të investimeve me fonde të Bankës Botërore.
- Rritja e shpenzimeve Postare lidhet me rritjen e numrit të konsumatorëve, pasojë e punës për uljen e humbjes dhe të lidhjeve të paligjshme në rrjetin e shpërndarjes dhe rritjes natyrale të numrit të abonentëve.
- Shpenzimet e Reklamave, Shpenzimet e Teknologjisë së Informacionit, Shpenzimet Ligjore dhe ato të Konsulencë – Auditimit janë ulur ndjeshëm në krahasim me vitin 2016 si edhe në krahasim me ato të buxhetuara.
- Rritja e shpenzimeve të Tjera prej 17.6% në krahasim me vitin 2016 është 17% më e ulët se vlera e buxhetuar, buxhet i cili ishte planifikuar me rritje të ndjeshme për shkak të financimit të projekteve të veçanta të miratuar të cilat lidhen me shpenzime të përditësimit të të dhënave të konsumatorëve etj.

Në total Shpenzimet Operacionale në krahasim me vitin 2016 ishin 5.8% më të ulta duke shënuar një kursim prej 0.7 miliard Lekë. Këto shpenzime ishin 20% më të ulta se ato të buxhetuar me një kursim prej rreth 2.9 miliard Lekë.

DEPARTAMENTI EKONOMIK

8. Shpenzimet e Amortizimit dhe Provigjonimet

OSHEE PASH (000 / Lekë)	2016	2017
Dëmtime dhe Provigjone	8,942,259	(1,729,748)
Zhvlërësimi dhe Amortizimi	(2,678,027)	(2,492,057)

Në vitin 2016 u bë rivlërësimi i Llogarive të Arkëtueshme tregtare i cili pati një ndikim pozitiv prej rreth 12 miliard Lekë në performancën e Shoqërisë.

Tabela më poshtë tregon Zhvlërësimin e Llogarive të Arkëtueshme Tregtare për vitin 2017, të cilat së bashku me provigjonimin për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar për Humbjet përbëjnë totalin e grupit të dëmtimeve dhe provigjoneve.

Kategoria (Lekë)	Zhvlërësimi në Llogaritë e Arkëtueshme Tregtare
Familjarë	1,145,683,720
Privatë	(499,464,681)
Buxhetorë	(174,995,927)
Jo-Buxhetorë	(1,587,522,901)
Zhvlërësimi Gjithsej	(1,116,299,789)
Provigjon për TVSH në humbje	(613,447,779)
Total	(1,729,747,568)

Kapitalizimi i Investimeve të vitit 2017 është akoma në proces dhe do të ndikojë në llogaritjen përfundimtare të Amortizimit si dhe do të ketë impakt në rezultatin ekonomik të shoqërisë për vitin 2017.

9. Shpenzimet Financiare dhe Tatim Fitimi

OSHEE PASH (000 / Lekë)	2016	2017
Shpenzime Financiare - neto	(839,890)	(112,346)
Të ardhura financiare	393,223	891,190
Shpenzime financiare	(1,233,113)	(1,003,536)
Të ardhura të jashtëzakonshme	115	109,899
Shpenzime Tatim Fitimi	(2,636,434)	(766,696)

DEPARTAMENTI EKONOMIK

Ulja e shpenzimeve financiare neto lidhet me:

- Interesa dhe Komisione Garancie për detyrimet e ristrukturuara ndaj CEZ a.s. ndaj të cilës janë kryer pagesat e para në vitin 2015 – 2016 dhe vlera e mbetur është më e vogël për vitin 2017. Për kreditë e tjera të trashëguara nga KESH interesat e llogaritura për kreditë e trashëguara për vitin 2017 janë rreth 269 milion Lekë.
- Të ardhurat dhe shpenzimet nga ndryshimet në kursin e këmbimit të vitit 2017.

Detaje për të ardhurat dhe Shpenzimet Financiare jepen në tabelën më poshtë:

OSHEE Financiare (000 / Lekë)	Dhjetor '16	Dhjetor '17
	Akumulative	Akumulative
Të ardhura nga këmbimet valutore	55,761	74,887
Të ardhura nga këmbimet valutore - të parealizuar	258,581	794,244
Të ardhura nga interesat e kredive dhe depozitave	78,882	22,058
Të ardhurat financiare	393,223	891,190
Shpenzime për interesa	(399,242)	(268,941)
Humbje nga këmbimet valutore	(56,535)	(34,797)
Humbje nga këmbimet valutore të parealizuar (Lekë)	(429,781)	(430,508)
Humbje nga këmbimet valutore të parealizuar (EURO)	-	(39)
Shpenzime financiare - të tjera	(347,556)	(269,252)
Kostot financiare	(1,233,113)	(1,003,536)
Kostot / Të ardhurat financiare neto	(839,890)	(112,346)

Të ardhurat e jashtëzakonshme kanë ardhur nga efekte të saktësimit të shuarjes së detyrimeve ndërmjet OSHEE – KESH – Institucioneve Buxhetore dhe Jobuxhetore sipas VKM të vitit 2015. Shpenzimet e tatim fitimit janë përlllogaritur paraprakisht duke marrë parasysh shpenzimet e panjohura sipas grupeve të cilat do të llogariten saktësisht në pasqyrat financiare kur të mbyllen përfundimisht.

DEPARTAMENTI EKONOMIK

D. KONKLUZIONE DHE PERSPEKTIVA

- Viti 2017 ishte vit i vështirë për aktivitetin e shoqërisë si pasojë e përballjes me efektet e thatësirës së jashtëzakonshme që solli rritje të ndjeshme të shpenzimeve të blerjes së energjisë elektrike. Për sistemin energjistik Shqiptar ky ishte viti me efektet më të mëdha në 25 vitet e fundit nga thatësira e tejzgjatur.
- Kalimi i situatës tejet të vështirë financiare gjatë vitit duke patur një humbje të ulët ishte një arritje e menaxhimit të shoqërisë dhe tregues i konsolidimit të mëtejshëm të ecurisë pozitive dhe perspektivës së ecurisë në vitet e ardhshme.
- Mbështetja me Kredi në kushte tejet të favorshme nga Qeveria Shqiptare bëri të mundur tejkalimin e vështirësive të likuiditetit.
- Vështirësitë financiare në pjesën e dytë të vitit 2017 nuk penguan vazhdimin e investimeve të cilat ishin rreth 9.7 miliard Lekë në të njëjtën vlerë me ato të vitit 2016.
- Në zbatim të kërkesave të ligjit “Për sektorin e Energjisë” shoqëria është në proces të ndarjes së aktivitetit të shpërndarjes nga ai i shitjes, proces i cili do të finalizohet së shpejti.